



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 53, datë 26.03.2025

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“ALBSIG” SH.A., SI REZULTAT I NDRYSHIMIT TË STRUKTURËS AKSIONARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, si dhe të Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të paragrafit të dytë të nenit 6, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Albsig” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare, si më poshtë:**

Ishte:

*“Struktura e kapitalit themeltar të Shoqërisë është si më poshtë:
-Shefqet Kastrati, zotërues i 879 460 aksioneve, që përfaqësojnë 100 % të kapitalit”.*

Bëhet:

*“Struktura e kapitalit themeltar të Shoqërisë është si më poshtë:
-Shoqëria “Kastrati” shp.k., zotërues i 879 460 aksioneve, që përfaqësojnë 100 % të kapitalit”.*

- 2. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e sigurimit “Albsig” sh.a., të aksionarit shoqëria “Kastrati” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI